**Raporti Dytë** (Draft raporti planit mbarështimit) ky raport duhet të hartohet në perputhje me udhëzuesin në fuqi për hartimin e PMPK. Ky raport në këtë fazë të punës përmbledh të gjithë të dhënat e marra e grumbulluar nga matjet direkte në terren dhe përshkrimin e elementeve teknike të n/ngastrave të kësaj ekonomie pyjore (duhet të paraqitet brenda afateve kohore të shprehura ne planin e punës së paraqitur).

**Raporti përfundimtar** paraqitet pas miratimit te PMPK, bazuar ne aktet ligjore në fuqi.

## 6. Detyrat që ndiqen për hartimin e planit të mbarështimit

Detyrat që duhet të zbatojë subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve janë:

- Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore;
- Përshkrimi i përgjithshëm në terren i ngastrave e n/ngastrave, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënjuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse; gjate punes (ne terren apo ne zyre) të mbahet parasysh se nuk duhet ndëruar numri dhe madhesia e parcelave nga ai aktuale, mund te kete shtese apo paksim te nenparelave sipas rastit por brenda konturit aktual te parceles.
- Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:

- Trungishte

- Cungishte

- Shkurre

- 
- Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës;
  - Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta);
  - Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve;
  - Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë;
  - Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës;
  - Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zonës;
  - Hartografimi i territorit të zonës duke përfshirë:
    - Ekonominë pyjore, ndarjen e ngastrave e të n/ngastrave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes;
    - Përdorimin e territorit të zonës;
    - Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve;
    - Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë;
      - Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të planit të mbarështimit;
      - Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësi;
      - Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore;
      - Propozimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit;
      - Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë;
      - Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre;
      - Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit me palët e interesuara;



- 
- Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Vau Dejës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat , perdoruesit etj).
  - Ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

### **Objektivat e përgjithshme dhe specifike të planit të mbarështimit**

Objektivi i përgjithshëm i planit të mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Shkoder (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifike të planit të mbarështimit do të jenë:

- Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat;
- Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë;
- Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve;
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor;
- Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues;
- Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues;
- Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit;
- Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve, dhe prerjeve të paligjshme;
- Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore;
- Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave;

- 
- Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.

7. Përmbajtja e Planit të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore do të përbëhet nga dhe jo vetëm:

1. HYRJE
2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË
3. GJENDJA AKTUALE E PYLLIT
4. VLERËSIMI I MBARËSHTIMIT TË MËPARSHËM
5. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT
6. MASAT PËR MBARËSHTIMIN E PYLLIT
7. GJENDJA DHE MASAT PËR INFRASTRUKTURËN
8. PLANIFIKIMI EKONOMIK
9. INDIKATORËT PËR MONITORIM DHE VLERËSIM
10. UDHËZIME PËR REVIZIONIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT
11. PLANI 10 VJEÇAR I PUNIMEVE TË PROPOZUARA SIPAS KATEGORIVE TË PUNIMEVE

PJESA E DYTË (Përshkrim parcelar) Lista e ngastrave, n/ngastrave me të dhënat kryesore.

PJESA E TRETË INVENTARIZIMI Rezultatet e sipërfaqeve prove etj

PJESA E KATËRT Harta e gjendjes ekzistuese (përdorimi i territorit)

Harta e punimeve të propozuara

Harta e përhapjes së llojeve drusore

Harta e ekonomisë pyjore sipas nën/ngastrave (Ortofoto)

Harta e shtrirjes së sipërfaqeve prove të përhershme dhe të përkohshme etj

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e planit të mbarështimit do të bazohet në Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e Planit të Mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

---

Plani i mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqërues do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 4 kopje të printuara dhe 4 kopje në format elektronik (CD).

**- MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT.**

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të Planit të Mbarështimit dhe punimet që realizohen nga subjekti kontraktor nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor. Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 3 specialistë të pyjeve (inxhinier pyjesh) nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë , të cilët do të monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Mbarështimit nga subjekti i kontraktuar

**- MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT.**

Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr 57/2020 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, kreu i tretë, neni 11, pika 2.b dhe 3.a; Projekti i Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore të hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët e fushës (Nj.administrative. shoqatat e pyjeve, komunitetin) dhe të miratohet në këshillin bashkiak, do të dërgohet zyrtarisht për konfirmim përfundimtarë, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

**Shënim: Punimet e terrenit do të kryhen gjatë periudhës së vegjetacionit.**

**Afatet e shërbimit:** Për realizimin e hartimit të Planit të Mbarështimit për këtë ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor 9 muaj sipas grafikut të ekzekutimit.

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

---

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

##### **2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

---

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një vit, për vitin e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës konkretisht **12 616 500** (Dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare, (Vitin e fundit).*

**2.2.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës dhe **faturen tatimore** të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë **të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.**

---

**Pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar duke filluar nga 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, *minimumi 12 (dymbëdhjetë) punonjës* ku ne perberje te numrit te punonjesve ne listpagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te jene te pakten 6(gjashte) inxhinier pyjesh duke perfshire drejtuesin teknik . Kjo kerkese eshte e rendesishme per krijimin e grupeve te punes te pakten 2-3 grupe pune per nga 3 specialist si dhe ekspertet e tjere do te kryejn punime zyre. Keto punonjes duhet të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimum për 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimum për 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

**2.3.3** - Operatorët ekonomikë pjesëmarrës bazuar në volumin e punës në këtë ekonomi pyjore në largësi nga rruga nacionale, kompleksitetin në kryerjen e këtij shërbimi, rëndësinë dhe pjekurinë profesionale, duhet të kenë të punësuar si staf teknik kryesor brenda numrit total të punësuar sipas pikes 2.3.2 kjo e percaktuar dhe ne manualin e planeve të mbarështimit që kerkohet që një grup pune të ketë ne perberjen e tij 3 specialiste pyjesh, specialistë të profileve me eksperiencë pune në fushat respektive, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 mujorin e fundit, në profesionet si më poshtë:

- **Drejtuesi teknik 1 (një) inxhinier pyjesh** i regjistruar në listpagesa që nga fillimi i vitit 2025 e në vazhdim i reflektuar në ekstraktin e kompanisë si drejtues teknik dhe i regjistruar në QKB si drejtues teknik(për të realizuar një planifikim shumë – funksional, për hartimin e metodikës, organizimin e stafit, planin e veprimit, grafikun e realizimit punimeve, mbrojtjen e studimit, si drejtues i grupit të punës)

**-4 (kater) Specialiste Pyjesh (Inxhinier),** të cilët do të jenë pjesë e grupeve të terrenit për ekonominë pyjore në studim (Stafit teknik) me përvojë në fushën e pyjeve dhe kullotave, Hartimin e Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimit të tyre të qëndrueshëm, aspekteve Silvo-pastorale, të mbrojtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore, të ketë aftësi të mira organizative në grup etj. Përdor mirë teknologjinë në marrjen e të dhënave të terrenit dhe regjistrimin online të tyre, sipas programeve të miratuara. Kjo kerkese eshte e parashikuar ne "Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 për grupet e terrenit sipas pikes D, D.1.1."Perberja e ekipit te punes" secili nga ekipet e punes se terrenit duhet të përbëhet nga 2 specialiste profesioniste (inxhinier pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert në punën e terrenit).

---

**-1 (një) Specialist GIS**, per ndarjen e ngastrave e n/ngastrave, përgatitjen e hartave të ndryshme sipas termave të referencës (dixhitalizimin, gjeoreferimin etj), përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave dixhitale (Inxhinier topograf/gjeodet/), i ***pajisur me Liçencë në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, nga autoritetet kompetente ligjore, ne listpagesa per tre mujorin fundit te deklaruar.***

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit teknik/ekspertëve kryesorë që do të angazhohë në kryerjen e këtij studimi, do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me dokumentat e mëposhteme:

**- Per inxhinierat e pyjeve perfshire dhe drejtuesin teknik duhet te paraqesin dokumentat si me poshte:**

- 1). Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)
- 2). Diplomë universitare.
- 3). CV-të, çertifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime.
- 4). Listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar
- 5). Per drejtuesin teknik listpagesat nga fillimi i vitit 2025 dhe ekstraktin e kompanise qe te jete i regjistruar ne ekstrakt si drejtues teknik.

**- Per inxhinierit Gjeodet duhet te paraqesin dokumentat si me poshte:**

- 1) Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)
- 2) Diplomë
- 3) Licence në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, leshuar nga autoritetet kompetente ligjore.
- 3) CV-të, çertifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime
- 4) Listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton numrin e punonjësve dhe, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit v-Operatori duhet te percaktoje me ane te nje deklarate nga Administratori i Shoqerise, Drejtuesin Teknik, i cili duhet te jete i punesuar sipas listpagesa, i profesionit Inxhinier Pyjesh, per te cilin duhet te paraqese:

Drejtuesi teknik duhet te paraqes dokumentat: Diploma, Kontrate pune si drejtues teknik, Lejen Profesionale te ushtrimit te profesionit per 4 kategorite, dhe të figurojë në list pagesat e shoqërisë qe nga fillimi i vitit 2025 (janar e ne vazhdim) si dhe te jete i pasqyruar ne Ekstraktin e shoqerise si drejtues Teknik i kompanise i regjistruar ne QKB.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori*



---

ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

#### **2.3.4 Staf teknik mbeshtetes.**

**Inxhinier pyjesh ose teknik 2(dy)**, me pervojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit, referuar Udhëzuesit të PM me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 ku “Secili nga ekipet e punës së terrenit duhet të përbehet nga 2 specialiste profesioniste (inxhinjere pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert në punën e terrenit)”, duke paraqitur dokumentat si më poshtë:

- 1)Kontratat individuale të punës (të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës)
- 2)Diplomë
- 3)CV-të, certifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime.

Kriteri 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4 plotesojnë dy grupet e punës për studimin e ekonomisë pyjore kjo e mbështetur në Manualin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 sipas paragrafit D.1.1 Secili nga ekipet e punës së terrenit duhet të përbehet nga 2 specialiste profesioniste (inxhinjere pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert në punën e terrenit). Kjo është përberja minimale e 1 ekipi që do punojë në terren.

**2.3.5** Për stafin kryesor të angazhuar, operatori duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimit që ka marrë përsipër të realizojë.

**2.3.6.**Operatori ekonomik duhet të disponoj **çertifikatat ISO** sipas formatit të miratuar në shqip dhe anglisht ku në fushën e certifikimit të jenë parashikuar punimet e Zhvillimit të Planeve të Menaxhimit në Pyje si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikata e mesipërme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

#### **2.3.7 Makineri dhe pajisje.**

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

| Lloji i mjetit/pajisjes                                   | Sasia  | Disponimi           |
|-----------------------------------------------------------|--------|---------------------|
| Diameter mates                                            | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Turjel per marrjen e kampioneve ne diameter               | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Lazer meter (dstance meter)                               | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Pjerresi mates+lartesi mates( Hypsometer) apo ekuivalent. | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Kompjuter dhe printera per punime zyre                    | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Busulla                                                   | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Meter shirit deri ne 20m                                  | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Peshore per peshimin e barit                              | 2 cope | Pronësi/ose me qera |

a)Për pajisjet e mesiperme , të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqese fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore, ose nje dokument tjeter qe verteton blerjen e pajisjeve, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë dhe fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 10.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

- I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| Identifikimi                                                                                                                                              | Përgjigjja |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | -----      |
| Numri NIPT/et:                                                                                                                                            | -----      |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar                                                                                                           | -----      |
| Përfaqësuesi (emri):                                                                                                                                      | -----      |
| Telefoni:                                                                                                                                                 | -----      |
| E-mail:                                                                                                                                                   | -----      |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

| <b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b> | <b>NIPT –i</b> | <b>Përqindja e nënkontraktimit</b> | <b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</b> |
|--------------------------------------------|----------------|------------------------------------|------------------------------------------------------------------|
|                                            |                |                                    |                                                                  |
|                                            |                |                                    |                                                                  |
|                                            |                |                                    |                                                                  |
|                                            |                |                                    |                                                                  |

- **Informacione për nënkontraktorin**
- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| <b>Emri (at) e subjekteve</b> | <b>NIPT-i</b> | <b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b> | <b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b> |
|-------------------------------|---------------|-----------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|
|                               |               |                                                                             |                                             |
|                               |               |                                                                             |                                             |
|                               |               |                                                                             |                                             |
|                               |               |                                                                             |                                             |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

**Deklarata**

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.<br>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.<br>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br><div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <span>Sqarime</span> <span>nëse</span> <span>vlerësohet</span> <span>e</span> </div> nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:</p> <p>Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.</p> <p>Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>7</sup>.</p> <p>Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:</p> <p>çmimet;<br/>metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

<sup>7</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

